

6.4 VERIFIKIMI I REGJISTRIMIT

Regjistrimi mund të verifikohet edhe për gabimet, të cilat mund të identifikohen në mënyrë automatike. Për të verifikuar saktësinë e futjes së të dhënave aplikohet kontrolli automatik (shih shtojcën *B*). Verifikimi automatik është i detyrueshëm veçanërisht për regjistrimet e vjetra, të shkarkuara nga sistemet e tjera.

Procedura

1. Klikoni skedën me regjistrimin, të cilin dëshironi ta verifikoni.
2. Përzgjidhni metodën **Kujtesa e fragmenteve / Verifiko regjistrimin**.
Nëse në regjistrim nuk ka gabime, programi na njofton për këtë.
Nëse në regjistrim ka gabime, hapet dritarja me listën e gabimeve. Në dritare mund të shfaqet:
 - titulli dhe të dhënat për përgjegjësinë
 - njoftimi për variantet e ndryshme të regjistrimit
 - lista e gabimeve dhe shënimet
3. Klikoni butonin **Në rregull**.




Figura 6.4-1: Gjetja automatike e gabimeve

Mundësitë...

Me metodën **Regjistrimi / Verifiko regjistrimin** mund të verifikoni edhe saktësinë e regjistrimeve në redaktues.